



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 156 Prot.

Tiranë, më datë 31.05.2024

VENDIM
Nr. 134, datë 31.05.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 31.05.2024:

VENDOSI:

1. Miratimin e rezultateve të vrojtimit arkeologjik për “Gjetjet sipërfaqësore në zonën e fshatit Bishçukas, Divjakë dhe propozimi për kryerjen e sondazheve arkeologjike në kodrën e Shën Gjergjit, Bishçukas”, realizuar nga DSHA;
2. Sondazhet arkeologjike në kodrën e “Shën Gjergjit”, të fshatit Bishçukas, të realizohen nga DSHA me mbështetjen e Bashkisë Divjakë dhe në bashkëpunim me Departamentin e Arekeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore të Fakultetit Histori Filologji;
3. Rezultatet e sondazheve arkeologjike të paraqiten në mbledhjen e radhës së KKTKM;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
5. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
6. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Sokol ISMAILI

